



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:111463

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05612852

PS.nr.36/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti Special, kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Kujtim Krasniqi, me bashkëpunëtorin profesional Laurant Avdyli, në çështjen penale kundër të pandehurit Z.V., për shkak të veprave penale Kontrabandim me mallra nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.32/18, të datës 15.04.2024, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 24.04.2024, në prezencën e Prokurorit të PSRK-së Burim Çerkini, të pandehurit Z.V., me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Haxhi Millaku, me datë 24.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Z.V., nga babai M. dhe nëna N., e vajzërisë S., i lindur me datë, në fshatin M. K. Z. P., ku edhe jeton, i martuar, baba i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal:....., s., shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

- I. Që nga viti 2017 e deri muajin Maj të vitit 2019, i pandehuri në vazhdimësi dhe në bashkëveprim edhe me pandehurit I. J., N. B., dhe S. L. dhe persona të tjerë të cilët gjenden në arrati, me qëllim të përfitimit. material të kundërligjshëm ka kontrabanduar kafshë nga Republika e Serbisë për Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, duke i 'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit mallrave, në atë mënyrë që kafshët nga territori i Republikës së Serbisë i ka kontrabanduar përtej kufirit nëpër mes rrugëve ilegale duke bashkëpunuar me tani të pandehurit bë cilësinë e personave zyrtarë në Polici të Kosovës ne SPMK-Z. P., ku këto kafshë fillimisht. i ka mbajtur feramat e tij e me pas, sipas marrëveshjes i kanë dorëzuar tek blerësit e tyre, ku për bartjen e kalëshëve si përfitim ka marre nga 35€ deri 55 € për një kafshë, me ç`rast duke u marre me këtë veprimtari i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës,

- Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale **Kontrabandim me mallra nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së**

II. Që nga Viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, i pandehuri në cilësinë e transportuesit të mallrave - kafshëve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, saktësisht për kalimin e mallrave - kafshëve kontrabandë, personave zyrtar - pjesëtarëve të policisë së Kosovës në regjionin e Mitrovicës stacioni policor ne Zubin Potok, ju ka dhënë para, në atë mënyrë që ata si persona zyrtar të veprojnë në kundërshtim me detyrat e tyre zyrtare, ashtu që i pandehuri Z.V., me rastin e importimit të mallrave me qëllim të shmangies së kontrollit doganor dhe tarifave, doganore, ka dhënë shuma të ndryshme të parave për kalimin e tyre, dhe atë por ngarkesë nga 80 € deri 100 €, sipas tarifave të përcaktuara paraprakisht, e që këtë shumë të parave iu ka dhënë direkt zyrtarëve policor, apo duke i lënë edhe në vende të caktuara, me ç ‘rast ka përfituar shuma të konsiderueshme të parave duke mos paguar detyrimet doganore për mallrat e transportuara ku me këto veprime edhe i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale **Dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së,**

Konform nenit 80 par.1 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit për veprat penale të lartpërmendura fillimisht ia shpallë dënimet për secilën vepër veç e veç si në vijim:

- Për veprën penale **Kontrabandim me mallra nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së,** të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë dënimin me gjobë në shumë prej 6.000.00 € (gjashtë mijë e pesëqind euro).**
- Për veprën penale **Dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së,** të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë dënim me burgim prej 6 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale në afat të verifikimit prej 1 viti si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 7.500.00 € (shtatë mijë e pesëqind euro).**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 6, 7, 17, 41, 43, 45, 46, 51, 73, 74 të KPRK-së, si dhe neneve 230, 359 dhe 364 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- **DËNIM ME BURGIM prej 6 muajve,** dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat të verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale, dhe

- **ME DËNIM UNIK ME GJOBË**, në shumë prej **13.500.00 € (trembëdhjetë mijë e pesëqind euro)**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe
- I akuzuari dënimin e shqiptuar mund të paguajë prej 3 (këste) këste me nga 4.500.00 (katërmijë e pesëqind euro) për këst në çdo 3 muaj nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.
- Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin unik me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimi unik me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga 20 € (njëzet euro).
- Obligohet i akuzuari që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 100€ (njëqind euro) dhe për fondin e viktimave të krimit shumë prej 100€ (njëqind euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS.nr.32/18, të datës 15.04.2024, kundër të pandehurit Z.V. për shkak të veprave penale Kontrabandim me mallra nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, ndërsa me datën 09.08.2023 është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë e cila është dorëzuar gjykatës së bashku me aktakuzën.

Me datë 24.04.2024, Kryetari i trupit gjykues pas pranimit të aktakuzës dhe marrëveshjes për pranim të fajësisë ka caktuar dhe ka mbajtur seancë dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku në pajtim me dispozitat e nenit 230 paragrafi 14 dhe 241 paragrafi 5 të KPPRK, ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ashtu që ka dëgjuar Prokurorin e PSRK-së Burim Çerkini, të pandehurin Z.V. me mbrojtësit e tij sipas autorizimit av.Haxhi Millaku.

Prokurori i Prokurorisë Speciale Burim Çerkini gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se bënë ndryshimin e marrëveshjes sa i përket dënimin të propozuar në marrëveshje ashtu që ka propozuar që për veprën penale sipas pikës II të aktakuzës, Dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dënimi i propozuar me 6 muaj burgim të kushtëzohet për 1 vit në rast se i pandehuri nuk kryen vepër të re penale, ndërsa gjoba e propozuar të jetë 7500 euro, ndërsa pjesa tjetër e marrëveshjes mbetet e pa

ndryshuar dhe i propozoj gjykatës që të njëjtën ta pranoj ashtu siç është lidhur në mes të prokurorisë dhe të akuzuarit.

Mbrojtësi i të pandehurit **Z.V., av. Haxhi Millaku** gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se marrëveshja është lidh me vullnet dhe pajtohet në tërësi me propozimin e prokurorit si dhe ndryshime të cilat i cekti në këtë seancë në procesverbal, i ka propozuar gjykatës që të aprovoj marrëveshje mbi pranim të fajësisë me këto ndryshime dhe heq dorë nga e drejta e çdo ankese në rast të aprovimit të kësaj marrëveshje për pranimin e fajësisë.

I pandehuri Z.V. ka deklaruar se pajtohet me thëniet e mbrojtësit të tij, i ka qarta të gjitha benefitet dhe pasojat lidhur me marrëveshjen për pranim e fajësisë, për veprat penale që i vihen në barrë, deklaroj se ndihet fajtorë.

2. Vlerësimi i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë

Gjykata pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.32/18, të datës 15.04.2024, e cila ka të bëjë me të pandehurin Z.V. për shkak veprave penale Kontrabandim me mallra nga neni 317 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, si dhe deklarimet për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në pajtim me dispozitat e nenit 230 par. 17 të KPP-së, gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vetë i pandehuri dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par.1 të KPP-së, për pushimin e procedurës përkatësisht hudhjen e aktakuzës, prandaj gjykata ka konstatuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.20 të KPP-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Prandaj, gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke gjetur se me të vërtetë i pandehuri ka kryer veprat penale ashtu siç përshkruhen në aktakuzë dhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe për këtë ka vendosur që të pandehurit ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i dëgjoji deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimet e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ashtu që duke gjykata i ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, andaj gjykata vlerëson se me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, dhe se dënimet e tilla të shqiptuar sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë janë në proporcion me veprat e kryera penale dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i pandehuri.

4. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPP-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 36 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 08/L-109).

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të neneve 230, 358, 364 dhe 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti Special

PS.nr.36/2024, i datës 24.04.2024

Bashkëpunëtori Profesional,
Laurant Avdyli

Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.